



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:245153

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06346058

KPPP.nr. 1360/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Banka Ekonomike Sh.A., me numër unik identifikues 810485864 dhe seli në Prishtinë, Sheshi "Nëna Terezë", p.nr., kundër debitorit F.K., me vendbanim në Velekincë, Komuna e Gjilanit, me numër personal 1231183694, të cilin e përfaqëson Avni Jashari, avokat nga Gjilani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 319/24, i lejuar me datë 07.08.2024, nga Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën, 24.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas prapësimit të debitorit F.K., të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 319/24, i lejuar me datë 07.08.2024, nga Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa.
- Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore Gjilan, Departamentit të Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës në këtë çështje përbarimore mes kreditorit Banka Ekonomike Sh.A., ndaj debitorit F.K., vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës dhe gjeti se Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike pranë Gjykatës Komerciale

nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit lidhur me këtë çështje.

Meqenëse në rastin konkret çështja përmbartimore zhvillohet në mes të kreditorit si person juridik dhe debitorit si person fizik, lidhur me kërkesën për pagesën e borxhit mbi bazën e titullit ekzekutiv – kontratës së pengut, ndërsa me nenin 13, paragrafi 1, pik 1.1 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, ndërsa me pikën 1.2 të të njëjtit nen, përcaktohet se: *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, pasi që në rastin konkret në cilësinë e kreditorit është personi juridik, ndërsa në cilësinë e debitorit është paraqitur personi fizik.

Ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykata dhe nenin 5, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Gjilan.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1360/24, datë 24.10.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.